



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery		07 - 12 2023		3 viti god year
Organ /Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKINSHICK	7351/2023		113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1313/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1313/2023 të datës 23.10.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1313/2023 e datës 23.10.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile e punësuar në pozitën "Zyrtare e Lartë - statistikat e shëndetësisë" në Agjencinë e Statistikave të Kosovës sipas Akt Emërimit me numër protokolli 04-112-239 të datës 03.04.2012, ankuesja më datë 23.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6633/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për harmonizim të koeficientit sipas Ligjit Nr.08/L-196 për pagat në sektorin publik, lidhur me kategorizimin e pozitës së saj në Kategorinë Profesionale 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.10.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Statistikave të Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 02.11.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht Aktin e Emërimit të datës 03.04.2012, rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtare e Lartë- statistikave e shëndetësisë" në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, me koeficient të pagës shtatë (7) sipas sistemit të vjetër të pagave.

Ankuesja me datë 23.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për harmonizim të koeficientit sipas Ligjit Nr.08/L-196 për pagat në sektorin publik, lidhur me kategorizimin e pozitës së saj në Kategorinë Profesionale 2, ndërsa e njëjta pretendon se përshkrimi i detyrave të punës është i barasvlershëm me pozitën e klasifikuar profesional 1.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se organi i punësimit, gjegjësisht Agjencia e Statistikave të Kosovës, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të



përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitive të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, përkatësisht deri me datë 30.09.2023, i cili afat me vendim të Qeverisë së Kosovës Nr.17/162 të datës 27.09.2023 është ndryshuar me që rast Institucionet kanë obligim ligjorë që të përfundojnë klasifikimin e vendeve të punës deri më datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankueses lidhur me kategorizimin e pozitës së saj është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritor, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme edhe në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në atë që u tha më lartë, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lartë, ankueses i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së saj të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1313/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

